



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 96, datë 30.07.2019

**PËR NDALIMIN E KANDIDIMIT TË Z. GËZIM ALLARAJ NË VENDIN VAKANT
PËR GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA PRESIDENTI
I REPUBLIKËS NË DATËN 07.02.2018**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

| | |
|-------------------------|--------------------|
| Ardian Dvorani | - Kryetar |
| Vitore Tusha | - Zëvendëskryetare |
| Arta Marku | - Anëtare/Relatore |
| Margarita Buhali | - Anëtare |
| Fatjona Memçaj | - Anëtare |
| Fatri Islamaj | - Anëtar |
| Eriol Roshi | - Anëtar |

Asistuar nga sekretare **Ermelinda Kadiu**,

Me praninë e **Avokates së Popullit, znj. Erinda Ballanca**, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- **z. Bledar Dervishaj**, përfaqësuesi i autorizuar i Presidentit të Republikës,

- **znj. Mimoza Arbi**, përfaqësuese e autorizuar e Kryetarit të Kuvendit,

në mbledhjen e datës **24.07.2019** dhe **30.07.2019**, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**KANDIDATI PËR GJYQTAR
NË GJYKATËN KUSHTETUESE:**

Z. Gëzim Allaraj

OBJEKTI:

Urdhërimi i ndalimit të kandidimit të **z. Gëzim Allaraj**, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën **07.02.2018**.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e anëtares së Këshillit, **znj. Arta Marku**, mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, zonja Erinda Ballanca, në cilësinë e vëzhgueses së përhershme në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/b të Ligjit nr. 8577/2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë*”, Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të ish-gjyqtarit Sokol Berberi.
2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Presidenti i Republikës i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000.
3. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese është edhe z. Gëzim Allaraj.
4. Në zbatim të nenit 125 dhe 149/d të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 7/b të ligjit nr. 8577/2000, të neneve 229, pika 1 e nenit 234, 235, 236, 237, 239 e 240 të Ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, si edhe të pikës 98 të aktit nënligjor normativ, Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbledhjen e zhvilluar në datën 05.04.2019, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese.
5. Në zbatim të nenit 228 të Ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2 datë 15.02.2019 “*Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion*”, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 05.04.2019, është realizuar edhe procedura për caktimin me short manual të relatorëve për secilin nga vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

6. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, relatore për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, znj. Arta Marku.

7. Z. Gëzim Allaraj, si njëri ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati Gëzim Allaraj, gjendet e administruar në dosjen e kandidatit.

8. Në datën 09.04.2019, kandidati Gëzim Allaraj është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidatit.

9. Në datën 15.04.2019, kandidati Gëzim Allaraj ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidatit.

10. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën nr. 265 prot, datë 19.04.2019, Këshilli i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas Ligjit nr. 8577/2000 dhe Ligjit nr.115/2016.

11. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidati Gëzim Allaraj, ku tregohet se është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës.

12. Me shkresën nr.2854/4 prot, datë 03.05.2019, ILDKPKI ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se kandidati Gëzim Allaraj e ka përmbushur detyrimin e përcaktuar nga pika 2 e nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016 për të dorëzuar të plotësuar pranë atij institucioni Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.

13. ILDKPKI, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115.2015, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, me shkresën nr.10/30 prot., datë 29.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Gëzim Allaraj dhe personat e lidhur me të.

14. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të pikës 4 të nenit 229 dhe 235 të ligjit nr. 115/2016, të shkronjës “e” të pikës 20, 24, shkronjës “b” të pikës 60 e vijues të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, edhe ky Këshill ka kryer veprimet verifikuese të kërimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit Gëzim Allaraj dhe personave të lidhur me të.

15. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidatit Gëzim Allaraj, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 17.04.2019, i është drejtuar me kërkesa për informacion institucioneve publike dhe subjekteve private (të cilat janë administruar në dosjen e kandidates), si më poshtë:

- a) Institucioneve bankare: (1) Banka Alpha Albania, (2) Banka Amerikane e Investimeve, (3) Banka Credins, (4) Banka e Bashkuar e Shqipërisë, (5) Banka e Kreditit e Shqipërisë, (6) Banka e Parë e Investimeve, (7) Banka Intesa Sanpaolo, (8) Banka Kombëtare Tregtare, (9) Banka Ndërkombëtare Tregtare, (10) Banka Procredit, (11) Banka Raiffeisen, (12) Banka Societe Generale, (13) Banka Tirana dhe (14) Banka Union.
- b) Institucioneve financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë : (1) Ak-Invest, (2) Albania Leasing, (3) Capital Invest, (4) Easypay sh.p.k, (5) Final sha, (6) Fondi Besa, (7) Iutecredit Albania, (8) Landeslease, (9) M – Pay sh.p.k. (10) NOA sha, (11) Porsche Leasing, (12) Posta Shqiptare, (13) Raiffeisen Leasing, (14) Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF, (15) Tirana Factoring & Lease, (16) Tranzit sha, (17) Union Financiar Tiranë.
- c) Subjekteve financiare të licencuar nga AMF : (1) Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension, (2) Fondi i Investimit Credins Premium, (3) Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro, (4) Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, (5) Fondi i Investimit Raiffeisen Vision, (6) Fondi i Investimit ËVP Top Invest, (7) Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, (8) Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal.
- ç) Institucione të tjera publike si : (1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës, (2) DPSHTRR, (3) D.P.Tatimeve, (4) M.Drejtësisë, (5) OSHEE, (6) QKB, (7) UKT.

16. Në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të gjitha institucionet publike dhe subjektet private të treguara në pikën 15 më sipër, kanë dërguar pranë Këshillit përgjigjet përkatëse ku përmbahen të gjitha të dhënat e kërkuara mbi pasuritë e kandidatëve, nëse kanë pasur të tilla për secilin prej tyre, përfshirë edhe kandidatin Gëzim Allaraj.

17. Në lidhje me rezultatet e kontrollit të ushtruar dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI, në datën 29.05.2019, Këshilli ka njoftuar në rrugë elektronike kandidatin Gëzim Allaraj për të dhënë shpjegimet përkatëse mbi këto gjetje, si edhe të depozitojë çdo dokument justifikues që ajo disponon.

18. Kandidati Gëzim Allaraj, në datë 03.06.2019, me nr. 375 prot., ka depozituar pranë Këshillit shpjegimet përkatëse duke bashkëlidhur edhe dokumentacion shtesë justifikues.

19. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 82 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën nr.110 prot, datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për kompetencë formularin e vetëdeklarimit të plotësuar sipas ligjit nr. 138/2015 nga kandidati Gëzim Allaraj.

20. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr.1134/208 prot., datë 29.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Gëzim Allaraj.

21. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidati Gëzim Allaraj, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli i është drejtuar më kërkesë për informacion Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (*shkresa nr.120 prot, datë 17.04.2019*), Shërbimit Informativ të Shtetit (*shkresa nr.114 prot, datë 17.04.2019*), Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (*shkresa nr.118 prot, datë 17.04.2019*) dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme (*shkresa nr.117 prot, datë 17.04.2019*).

22. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në vijim të procedurës së sipërcituar për verifikimin e integritetit, me shkresën nr.352 prot., datë 20.05.2019, i është drejtuar Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar me kërkesë për ndihmë administrative për përpunimin e informacionit të klasifikuar të kërkuar pranë institucioneve përkatëse ligjbatuese për qëllimet e verifikimit të integritetit të kandidatëve.

23. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme kanë dërguar përgjigjet e tyre, përkatësisht me shkresat *nr.1545 prot., datë 10.06.2019* dhe *nr.680/1 prot., datë 15.05.2019*, mbi të dhënat e kërkuara për të gjithë kandidatët, përfshirë edhe kandidatin Gëzim Allaraj.

24. Në vijim të procedurave të verifikimit dhe kontrollit të integritetit, në zbatim të nenit 229 dhe 236 të Ligjit nr. 115/2016, të dispozitave të ligjit nr. 45/2015, si edhe në zbatim të pikës 85 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën nr.112 prot, datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar

formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nr. 45/2015 nga kandidati Gëzim Allaraj për kompetencë dhe shqyrtim pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

25. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr.551/1 prot., datë 03.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Gëzim Allaraj.

26. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91- 93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli ka marrë në shqyrtim dokumentacionin përkatës të depozituar nga vetë kandidati Gëzim Allaraj në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant.

27. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, Këshilli në datën 02.05.2019 i është drejtuar më kërkesë për informacion partive politike, si dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (shkresa nr. 270 prot., datë 19.04.2019), duke i bashkëlidhur listat e të gjithë kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë. Në përgjigje të këtyre kërkesave, KQZ dhe parti politike kanë dërguar informacione lidhur me ekzistencën ose jo të të dhënave që do të vërtetonin angazhimin në ndonje pozicion drejtues në parti politike të secilit prej kandidatëve, përfshirë edhe kandidatin Gëzim Allaraj.

28. Në zbatim të pikës 1 dhe 2 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000, nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 28.06.2019, i ka kërkuar kandidatin Gëzim Allaraj të paraqesë shpjegime me shkrim dhe dokumente shtesë lidhur me veprimtarinë e tij profesionale për periudhën 2000 e në vazhdim, për të cilën, në jetëshkrimin e tij ka deklaruar se ka ushtruar funksionin e avokatit, duke e orientuar për të vënë në dispozicion të Këshillit edhe dokumente zyrtare nga institucioneve të tilla si ato të sigurimeve shoqërore, drejtori tatimore në lidhje me pagimin e detyrimeve përkatëse në këto institucione sipas llojit të veprimtarisë së deklaruar.

29. Në datën 03.07.2019, kandidati Gëzim Allaraj ka depozituar pranë Këshillit shpjegime dhe dokumente shtesë (si vendime gjyqësore, prokura përfaqësimi, vërtetime etj.), të protokolluar me nr. 417, për të provuar vitet e ushtrimit të profesionit të avokatit.

30. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit nr. 115/2016, si edhe të pikave 29, 75 dhe 87 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, duke vlerësuar paraprakisht se ka të dhëna dhe gjetje që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, anëtarja relatores e Këshillit, znj.Arta Marku ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e ka dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

31. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 17.07.2019, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt shqyrtimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidimit të z.Gëzim Allaraj, për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

32. Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidatit Gëzim Allaraj.

33. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materiale të çështjes, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

34. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 17.07.2019, rendin e ditës dhe relacionin e përgatitur janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

35. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, si edhe rendi i ditës janë njoftuar publikisht edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

36. Në mbledhjen e Këshillit, pas relatimit të parashtruar nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoi mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit Gëzim Allaraj.

37. Në thelb, Avokati i Popullit, krahas qëndrimit të përgjithshëm se edhe për këtë rast nuk ka pasur nga KED në dispozicion dokumentacionin e plotë që vërteton ezaurimin e kriterëve dhe kushteve të tjera ligjore, parashtron se referuar të dhënave që rezultojnë nga vërtetimet e lëshuara nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë (vitet 2003 dhe 2017) për periudhën e ushtrimit të profesionit të avokatit, rezulton se ka mospërputhje të datës së fillimit të ushtrimit të këtij profesioni, duhet thelluar hetimi. Sipas vërtetimit të vitit 2003 rezulton anëtar i Dhomës nga viti 1999, ndërsa sipas vërtetimit të vitit 2017 rezulton anëtar i Dhomës nga viti 2000. Lidhur me pasurinë, janë evidentuar probleme në deklarimin e pasurisë nga ILDKPKI, për të cilat i janë kërkuar shpjegime kandidatit, por në relacion mungon një analizë e mirëfilltë lidhur me gjetjet sa i takon procesit të verifikimit të pasurisë së tij.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

38. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidatit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për ndalimin e kandidimit të kandidatit Gëzim Allaraj për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

39. Në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës, parashikohet se :

“4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kritere të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.”

40. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se:

“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;*
- b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;*
- c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;*
- ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;*
- d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;*
- dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.*

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

- a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;*
- b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;*
- c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.”*

41. Kushtet e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet e nxjerra në pajtim me të, sikurse janë edhe ato të përmendura në pikat 39 dhe 40 më sipër, duhet të plotësohen secila dhe të gjitha së bashku në mënyrë që kandidati të pranohet për tu vlerësuar dhe renditur sipas meritave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe më tej për tu përzgjedhur gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nga organi i emërtesës.

42. Nëse kandidati për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese nuk plotëson qoftë edhe njërin prej kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, kjo do të përbënte motiv ligjor të mjaftueshëm për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi për të vënë në bisedim dhe për të disponuar ndalimin e kandidimit, pa qenë më e nevojshme të arsyetojë për plotësimin ose jo të kushteve të tjera ligjore.

43. Nisur nga të dhënat dhe gjetjet që rezultojnë nga procedura e verifikimit për kandidatin Gëzim Allaraj, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerësoi të bisedojë dhe të konkludojë pikësisht në lidhje me plotësimin ose jo të kushtit ligjor të parashikuar nga shkronja “dh” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe neni 235 i ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati duhet të ketë *“kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij”*.

44. Për sa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë, në përfundim të veprimeve të verifikimit dhe të kontrollit të ushtruar në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, ILDKPKI, me shkresën nr.10/30 prot., datë 29.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Gëzim Allaraj dhe personat e lidhur me të.

45. Në përfundim të analizës së hollësishme financiare të kryer mbi bazën e gjetjeve të siguruar nga informacionet e dërguara nga institucione publike dhe subjekte private, lidhur me deklarin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit Gëzim Allaraj, ILDKPKI në raportin e paraqitur ka ardhur në përfundimet se:

- a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin,
- b) ka mungese dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e pasurive;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- ç) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

46. Përfundimet e sipërcituara të ILDKPKI, bazohen në gjetjet vijuese të raportit të kontrollit:

- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin financiar të përdorur për blerjen e banesës me sip. 110 m² dhe 300 m² truall në P*****, Tiranë në vitin 2003 në shumën 725.000 lekë. Referuar institucioneve përkatëse, konfirmohet se aktiviteti si PF “Avokat” është i regjistruar në datë 08.10.2007, ndërsa nuk konfirmohen të ardhurat e përfituara nga prodhimet bujqësore dhe si mësues.
- Dokumentacioni i shitblerjes të pasurisë së mësipërme nuk është i plotë, dhe nuk është i nënshkruar para noterit. Është i paqartë fakti nëse janë kryer investime në këtë pasuri, si dhe gjykohet se vlera e blerjes në vitin 2003 të jetë e ulët.
- Është e paqartë pronësia e deklaruar nga Gëzim Allaraj lidhur me tokën bujqësore në Xh***** -Kukës, pasi AMTP e paraqitur është në emër të shtetasit B.A. . AMTP nuk e ka të qartë nëse sipërfaqja e tokës bujqësore është 13.948 m² apo 6.030 m².
- Nuk është përmbushur detyrimi ligjor për deklarimin e të ardhurave, kjo e përcaktuar në faqen nr.4 të formularit të deklaratës së pasurisë “Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre”.
- Është i paqartë burimi financiar që ka shërbyer për llogaritë/depozitat e konfirmuara nga Procredit Bank, pasi nuk janë deklaruar, dokumentuar të ardhurat nga kandidati. Nuk konfirmohen të ardhurat nga institucionet përkatëse për periudhën 2000-2007.
- Është i paqartë burimi financiar që ka shërbyer për vlerën 1.830.400 lekë depozituar në datë 10.1.2014, në Credins Bank, pasi nuk janë deklaruar dhe dokumentuar të ardhurat nga kandidati.

47. Në zbatim të pikës 26 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, nisur nga gjetjet e sipërcituara, në rezultatet e kontrollit të ushtruar dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI, në datën 29.05.2019, Këshilli ka njoftuar në rrugë elektronike kandidatin Gëzim Allaraj për të dhënë shpjegimet përkatëse mbi këto gjetje, si edhe të depozitojë çdo dokument justifikues që vlerëson se e disponon.

48. Kandidati Gëzim Allaraj, në datën 03.06.2019, me nr. 375 prot., ka depozituar pranë Këshillit shpjegimet përkatëse me shkrim duke bashkëlidhur edhe dokumentacion shtesë justifikues, nëpërmjet të cilit, në thelb, parashtrohet se :

Për sa i përket vlerës së banesës, pra të blerjes së banesës, ILDKPKI është totalisht paragjyquese dhe aspak korrekte,

Së pari: banesa në momentin e blerjes ishte mjaft e vjetër dhe ndërtimi para 1970 dhe se çmimin ia ka vendosur shitësi jo blerësi dhe se unë nuk kam asnjë lidhje apo njohje me të. Pastaj çmimet e referencës në atë kohe nuk ekzistonin pra thjeshtë vullneti i palës në e dimë që një banesë në ato vite apo me parë është blerë dhe disa herë më pak se vlera e shtëpisë të blerë nga unë dhe shkresa e thjeshtë ka fuqi provuese sipas K.Pr.Civile dhe për gjykatën pra përkatësisht duhet të ketë fuqi provuese dhe për ILDKPKI. Gjithashtu në kohën e blerjes së banesës interesi im ishte ndoshta që vlera të ishte më e lartë për arsye të tregut pasi nuk kishte çmime reference, pra gabimisht dhe padrejtësisht paragjykohet vlera e banesës.

Me lejoni të shtoj se unë me familjen time prindërore kam patur dhe mbajtur dy invalidë, rrethana të cilat më kanë imponuar të blejë këtë shtëpi me vlerë të ulët.

Sa më sipër provohet se ILDKPKI ka gabuar në konkluzionin e saj, pasi ajo kërkon që faktet e mëparshme dhe me një legjislacion tjetër në fuqi të bëheshin sipas standardeve të tanishme ku tashmë janë përmirësuar treguesit e legjislacionit por megjithatë kemi banesa të para viti 1990 në proces legalizimi që për arsye të vlerës së tyre të ulët si ndërtim regjistruesi është kujdesur të bëhen falas pra qeveria është treguar realiste ndryshe nga ILDKPKI si në rastin tim. Përsa i përket investimeve unë kam deklaruar se kam kryer investime tejet të thjeshta të cilat i kam deklaruar tek detyrimet financiare detyrimi kreditor nga FIBANK.

Pra ku është këtu paqartësia, vlera e shtuar banesës është brenda vlerës së kredisë të marrë nga FIBANK pra më e vogël se 300.000 (treqind mijë) lekë.

Dhe në lidhje me mungesën e dokumentacionit justifikues ligjor për burimin e financimit të përdorur për blerjen e banesës në vitin 2003 ILDKPKI arrin në përfundimin se nuk konfirmohen të ardhurat e përfituara nga prodhimet bujqësore e blegtorale dhe si mësuës. Unë kam deklaruar që shuma ose sasia kryesore e burimit financiar të blerjes së banesës janë nga shitja e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale që nga viti 1991 e në vazhdim dhe dy vjet si arsimtar dhe për këtë kam depozituar ATM në pronësi në fshatin Xh*****, Kukës ku unë rezultoj si bashkëpronar i 13948 m² tokë bujqësore tokë të cilën e kemi punuar rregullisht dhe kemi prodhuar kryesisht me shumicë kulturën e patates të cilën e kemi tregtuar sipas kërkesave të tregut e cila për atë periudhë është mjaft fitimprurëse dhe madje vazhdon të jetë edhe nga shitja e saj kemi kursyer vit pas viti dhe deri në vitin 2003 por madje dhe më vonë nuk kishte asnjë detyrim për mbajtje faturash shitblerje nga palët shitblerëse por thjesht shisje mallin dhe merrje paratë.

Pra nuk kam asnjë detyrim ligjor sipas ligjit në fuqi sot që për periudhën 1991-2003 të paraqes para ndonjë institucioni faturat e shitjes.

Pra konkluzioni i ILDKPKI se nuk konfirmohen të ardhurat e përfituara nga prodhimet bujqësorë nuk është ligjor madje mund të them se rezulton abuzues. Unë kam paraqitur ATM në pronësi dhe se saktësoj se kam bashkëpronar ndërsa ILDKPKI me konsideron pronar. Unë deklaroj dhe paraqes prova se jam një bashkëpronar i tokës bujqësore pra me kryefamiljar të tokës bujqësore vëllai im më i madh B.F.A. me të cilin akoma tokën bujqësore de jure e kemi të përbashkët dhe duke e punuar deri në 2003 kemi ndarë fitimet.

Të ardhurat që realizonim nga produktet blegtoralë dhe bujqësore i kam depozituar në bankën pro kredit dhe janë po ato lekë që kam blerë banesën pra një pjesë prej tyre. Ndërsa për shkak të kohës se kufizuar duke e konsideruar të pamjaftueshme duke ditur gjendjen e institucioneve të lidhje me kthimin zyrtar të përgjigjes kur iu drejtohesh nuk kam arritur të sjellë dokumenta mbi punën si mësues pra diçka të thjeshtë si provë zyrtare.

Gjithashtu për sa i përket momentit të fillimit të profesionit si avokat, në vitet 2005 regjistrimet si person fizik pra si avokat pas marrjes së licencës profesionale bëhet tek noterët dhe as në gjykate e as në QKR. Kështu për asnjë kohe nuk mund të siguroj aktin noterial të regjistrimit si person fizik por kam siguruar një dokument zyrtar ku unë kam derdhur sigurimet shoqërore për periudhën deri në Gusht 2003 pra nuk është momenti i fillimit të profesionit viti 2006 apo 2007 por viti 2000.

Për një veprim në Credins Bank viti 2014 më kujtohet se ishin të nipit, djalit të motrës që do të ikte jashtë shtetit, dhe kursimet e tij deshi ti linte në llogarinë time, në mirëbesim për t'ia ruajtur por ndryshoi mendim por i tërhoqën, dhe nga ajo kohë vazhdon të jetë jashtë shtetit.

Në lidhje me konkluzionin e ILDKPKI se nuk është përmbushur detyrimi ligjor për deklarimin e të ardhurave kjo e përcaktuar në faqen 4 të formularit të deklaratës së pasurisë:

Është konkluzion i saktë dhe i drejtë i ILDKPKI është e paqëllimshme nga ana ime por nuk e kam kuptuar drejt këtë përmbushje detyrimi dhe pasi u konsultova me kontabilistin tim ju vë në dispozicion të ardhurat e mia nga biznesi për 5 vitet e fundit aq sa është e mundur të dalin nga sistemi tatimor gjithsej fletë gjashtë 6.

Në përfundim të këtyre shpjegimeve mund të them se verifikimi i pasurisë time duhet të jetë i përqëndruar tek puna si avokat nga e cila rezulton se depozitat e mia nuk janë rritur përkundrazi prej më shumë se 10 vite. Deklaroj çdo çështje gjyqësore dhe për burimin financiar para viti 2003 nuk kam asnjë detyrim ligjor të paraqes dokument provues të mirëfilltë të posaçëm por kam paraqitur dokumenta provuese të mjaftueshme dhe në total dhe përfundimisht mund të them se nga që nuk abuzoj me detyrën si avokat dhe punoj me tarifa ligjore, jam kategorik kundër korrupsionit e prandaj kam një pasuri tejet modeste sa ka çdo njeri i thjeshtë në këtë vend.

49. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi përputhshmërinë e të dhënave të deklaruara nga kandidati Gëzim Allaraj në *Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë* që ka depozituar pranë ILDKPKI, mbi bazën e të cilave ky institucion ka realizuar analizën financiare dhe ka ardhur në përfundimet e tij të sipërcituara, në raport edhe me të dhënat që rezultojnë nga informacionet e dërguara pranë Këshillit nga institucionet publike dhe private të treguara në pikën 15 të këtij Vendimi, sikurse edhe shpjegimet dhe dokumentacionin shtesë si më sipër të paraqitur nga kandidati Gëzim Allaraj.

50. Mbi bazën e verifikimeve të kryera, Këshillit i rezulton se me të drejtë nga ana e ILDKPKI në raportin e përcjellë pranë Këshillit dhe që i është vënë në dispozicion kandidatit Gëzim Allaraj është konstatuar se dokumentacioni nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin dhe se ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e pasurive.

51. Kështu, rezulton se banesa e blerë nga kandidati në vitin 2003 në fshatin P***** , Komuna Petrelë në atë kohë, sot Njësia Administrative Petrelë, Bashkia Tiranë është blerë nga kandidati kundrejt çmimit 725.000 lekë, në vitin 2003 me shkresë të thjeshtë dhe jo akt noterial . Përveç banesës me sipërfaqe 110 m² me të njëjtin akt është blerë edhe truall prej 300 m² në të njëjtin vend .

52. Pra, kandidati e ka blerë pasurinë e paluajtshme si truallin ashtu edhe banesën pa akt noterial në një kohë që ligji (neni 83 i Kodit Civil) kërkon formën noteriale për kryerjen e këtij veprimi juridik. Është e vërtetë që edhe teorikisht por edhe nga praktika unifikuese e Gjykatës së Lartë titulli i pronësisë nuk e humb vlerën e tij, por nga ana tjetër nuk ligji e kërkon formën noteriale të aktit të tjetërsimit të pasurive të paluajtshme dhe regjistrimin e saj për efekt të krijimit të sigurisë juridike tek të tretë. Në rastin konkret forma noteriale e veprimit juridik do të provonte edhe për efekte tatimore çmimin e shitjes së banesës dhe truallit, datën e lidhjes së kontratës. Pasja e kësaj forme do t'i jepte fuqi provuese të plotë kontratës dhe për rrjedhojë do të rrezonte edhe konstatime e ILKPKI-së.

53. Në lidhje me konstatimin e ILDPKI-së se nuk është përmbushur detyrimi ligjor për deklarimin e të ardhurave, kjo e përcaktuar në faqen nr.4 të formularit të deklaratës së pasurisë “Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre”, ky fakt provohet si nga deklarata e administruar e pasurisë ashtu edhe nga shpjegimet e kandidatit të datës 03.06.2019 ku kandidati shprehte ndër të tjera, Këshilli citon : “Është konkluzion i saktë dhe i drejtë i ILDKPKI është e paqëllimshme nga ana ime por nuk e kam kuptuar drejt këtë përmbushje detyrimi dhe pasi u konsultova me kontabilistin tim ju vë në dispozicion të ardhurat e mia nga biznesi për 5 vitet e fundit aq sa është e mundur të dalin nga sistemi tatimor gjithsej fletë gjashtë 6”. Pra, Këshilli gjendet në këtë rast përpara një mospërmbushje formale të detyrimit që rrjedh për kandidatin nga nenin 235/2 i Ligjit 115/2016 ‘Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë’ sipas të cilit : “2. Jo më vonë se 15 ditë nga marrja e formularëve për deklarimin e pasurive dhe të interesave financiarë, kandidatët i dorëzojnë ato të plotësuar pranë Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, i cili kryen kontrollin e saktësisë dhe të vërtetësisë së deklaramit brenda 30 ditëve nga paraqitja e tij”.

54. Për këto arsye, në zbatim të nenit 7/a, pikës 1, të shkronjës “dh” të ligjit nr. 8577/2000 “Për Organizimin dhe Funkionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, Këshilli vjen në përfundimin se kandidati Gëzim Allaraj nuk plotëson kushtin që të ketë “*kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij*”. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, ky kandidat gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit për sa i përket verifikimit të pasurisë.

55. Këshilli vlerëson të ritheksojë se kushtet e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet e nxjerra në pajtim me të, duhet të plotësohen secila dhe të gjitha së bashku në mënyrë që kandidati të pranohet për tu vlerësuar dhe renditur sipas meritave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe më tej për t'u

përzgjedhur gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nga organi i emërtesës. Në rast se kandidati nuk plotëson qoftë edhe njërin prej kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, kjo do të përbënte motiv ligjor të mjaftueshëm për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi për të disponuar ndalimin e kandidimit, pa qenë më e nevojshme të arsyetojë për plotësimin ose jo të kushteve të tjera ligjore.

56. Për këto arsye, duke ardhur në përfundimin se në lidhje me kandidatin Gëzim Allaraj është i mjaftueshëm të vendoset ndalimi i kandidimit për motivin e mosplotësimin të kushtit ligjor të përcaktuar nga shkronja “dh” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, Këshilli vlerëson se nuk është vendi për të vijuar me tej me analizë dhe arsyetim mbi plotësimin ose jo të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit.

57. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se duhet të vendoset ndalimi i kandidimit të kandidatit Gëzim Allaraj në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të nenit 7/a dhe 7/b të ligjit nr. 8577/2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*”, të pikës 3 të nenit 229 dhe pikës 4 të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, si edhe të shkronjës “b” të pikës 50 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Ndalimin e kandidimit të kandidatit Gëzim Allaraj, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatit Gëzim Allaraj.
3. Kandidati Gëzim Allaraj ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI

Ardian DVORANI